**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E APELIT TIRANË**
**KRYETARI**

*Bulevardi "Zhan D'Ark" Tiranë, SHQIPËRI* *Tel/Fax: 00 355 042 260284*

**Nr.---57---- Prot.** **Tirane, me 22.05.2012**

# VENDIM

**Unë, Kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Alaudin MALAJ, në mbështetje të nenit 18 pika 1 dhe 3, shkronja"b" të ligjit nr.9877 date 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregulloren e Brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Gjyqësore", miratuar me Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë nr.1830 datë 03.04.2001,**

**Kur Gjykata e Apelit Tiranë vepron me proçedurë të përshpejtuar?**

## VENDOSA

Çështjet gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Tiranë shqyrtohen në bazë të një rradhe gjykimi në përputhje me periudhën e regjistrimit pranë sekretarisë gjyqësore. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm për ato raste të cilat, si pasojë e afateve të shkurtra për gjykim, parashikuar nga legjislacioni në fuqi, apo nevojës për vazhdimin e gjykimit në shkallët e tjera, shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar.
Raste kur Gjykata e Apelit Tiranë vepron me procedurë të përshpejtuar janë si më poshtë vijon:

**A. Për çështje civile:**

1. Çështje për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur kthim për rigjykim.
2. Çështje që kanë ardhur për herë të dytë ose të tretë në Gjykatën e Apelit.
3. Konflikte pune e pensione pleqerie.
4. Lënie fëmije për rritje, edukim e detyrim për ushqim.
5. Masat provizore

6. Pushimet e gjykimit
7. Pezullimet e gjykimit
8. Interpretime vendimi
9. Akte te tjera administrative me karakter te ngutshem

**B. Për çështje penale:**

1. Çështje te prishura e kthyer për rigjykim
2. Heqje dore nga ankimi
3. Rastet e Amnistisë.
4. Masat e Sigurimit.
5. Raste kur ka vendim të pezullimit të ekzekutimit.

**KRYETARI**

**ALAUDIN MALAJ**